



# Relacion teknik

Objekti: MURE ME PILOTA NE RRUGEN "VELLEZERIT  
FRASHERI"

LAGJJA "KONGRESI I LUSHNJES"

# ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE



## 1. HYRJE

Ne procesin e zhvillimeve ekonomiko-shoqerore dhe kerkesave urbane te qytetit te Lushnjes nevoja per permiresimin e rrjetit rrugor eshte nje kerkese urgjente. Rruga “Vellezerit Frasheri” kete urgjence e ben me te domosdoshme per faktin se ne kete rruge eshte shfaqur fenomeni i rreshqitjes dhe rruga ka pesuar demtime te dukshme, te cilat rrezikojne banesat qe ndodhen ne kete rruge si dhe perdorimin e automjeteve .

## 2.OBJEKTI I RELACIONIT

Mbeshtetur ne detyren e projektimit dhe kerkesat e Bashkise Lushnje objekti i ketij relacioni teknik eshte paraqitja e projekt zbatimit ku prezantohen masat inxhinjrike dhe zgjidhjet e nevojshme, arkitektonike dhe inxhinjrike qe jane parashikuar ne projekt per zgjidhjen e problemit te krijuar duke nderhyre ne disiplinimin e ujrave te shiut dhe ne ndertimin e pilotave dhe mureve mbajtes.

Bazuar ne azhornimin ne terren te rruges dhe shqyrtimin e dokumentave perkates u realizua projekt zbatimi.

## 3.ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

### 3 a. Analiza urbane

Rruga “Vellezerit Frasheri” ndodhet ne lagjen “Kongresi I Lushnjes”. Ajo ka nje gjatesi 175 ml .Rruga eshte ne nje terren te pjerrret. Ne anen e majte te rruges banesat ndodhen nen nivelin e rruges me njedisnivel qe varion nga 3 deri ne 6 m. Ne anen e djathte banesat jane mbinivelin e rruges ne kuotat 2-3 m nganiveli i rruges. Gjeresia e rruges eshte 3.5 deri ne 4.5 m. Banesat ne dyanet e rruges jane 2-3 kate.



## PAMJE NE FILLIMIN E RRUGES




### 3.b .Analiza inxhinierike

Banesat ne kete rruge jane ndertuar reth viteve 1990-1992 .Gjate ndertimi te banesave jane bere zbankimet e dherave ne koder per te krijuar sheshe ndertimi.Ka qene e domosdoshme drejtimi i ujrave sipërfaqesor me qellim te mos krijohet mbingopje te dherave dhe rreshqitje te tyre Keto mure mbajtese jane ndertuar jo profesionalisht duke mos realizuar mbrojtjen

.Gjate ketyre viteve,ne nje segment ne gjatesi prej 40 m, rruga ka pesuar plasaritje te cilat kohet e fundit kane avancuar duke krijuar carje me gjeresi deri ne 0.5 m dhe avacojne ne thellesi nga viti ne vit. Pervec rrezikut qe ka per banesat plasaritjet ne rruge ka bere qe pjesa e kalushme ne rruge te jete deri ne 2.5 m pra te zvogeloj gjeresine e rruges.

Ne kete rruge nuk ka KUB ndersa rrjeti i Kuz-se eshte ekzistues .

### PAMJE TE RRESHQITJES NE RRUGE





## PAMJE TE CARJES NE RRUGE



### 3 c Konkluzione dhe rekomandime

Nga analiza e bere per gjendjen ekzistuese propozohen nje sere masah per tu realizuar.

-Rregullimi i parametrave teknik te rruges per disiplinimin e ujrave te shiut

Per kete duhet te rregullohet pjerresia terthore e rruges dhe ndertimi i kunetes anesore.

-Ndertimi i nje muri mbajtes me pilota ne pjesen poshtme te rruges dhe ndertimi i nje muri mbajtes butobetoni ne pjesen e sipërme te rruges.



#### **4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

Projekti i hartuar propozon marrjen e masave inxhinjrike për përmirësimin e gjendjes së krijuar si dhe për të realizuar mbrojtjen e rruges nga rreshqitja.

Projekti i konsultuar me Ing. Gjeolog të fushës propozohen struktura mbajtëse për rrugën të tipit mure me pilotë betonarme. Pilotat do të inkastronin në formacion shkëmbor. Sipas disnivelit të përcaktuar nga azhurnimi në vend do të perdoren 2 tipe pilotash. Pilotat do të jenë beton/arme dhe të armuar me hekur Ø16 dhe stafa hekuri Ø18 çdo 15 cm në drejtimin tërthor. Armimi i detajuar i pilotës është paraqitur në projekt. Pilotat janë prashikuar që të derdhen në vend duke bërë germimin me makineri të posaçme. Pas germimit të pilotës vendoset armatura e përgatitur me hekur punues dhe stafa sipas detajeve në projekt dhe me pas do të derdhet betoni sipas klases së paraqitur në projekt. Do të kihet parasysh gjatë fazës së zbatimit vibrimi i betonit të pilotave me qellim largimin sa më të madh të bulzave të ajrit. Në fillim do të betonohen pilotat punues dhe më vonë do të ndërtohen pilotat beton të pa armuar sipas detajit të paraqitur në projekt. Të gjitha pilotat do të lidhen me njëra-tjetrën me permasa 60 me 60 cm. Trau do të lidhen të gjitha kokat e pilotave me qellim që të gjitha pilotat të punojnë si një trup i vetëm. Trau do të jenë betonarme dhe do të armohen 9 Ø18. Gjithashtu gjatë fazës së zbatimit të zbatohen rregullat e sigurimit teknik.

Në projekt është parashikuar dhe një mur mbajtës butobetoni me një gjatësi 15 m dhe me një lartësi 1.2 m si dhe pjesa e skarpës mbi murin të sistemohet me këndin 45 grad. Për të sistemuar kullimin e ujërave të shiut në anën e brendshme të rruges është parashikuar një kuletë betoni për mbledhjen e ujërave. Detaji i kuletës dhe i murit mbajtës buto-beton është paraqitur në prerjen 1-1.

Për ujrat që vijnë nga kodra dhe pallati afër rruges është parashikuar dhe një zgare hekuri që do të shkarkoj nepermjet tubacionit të ri që do të ndërtohet dhe do të derdhet në kanal në ujërave të larta.

Rruga do të riasfaltohet në pjesën e demtur duke i ndryshuar pjerresinë në seksionin tërthor të saj në drejtim të kodrës.



## **5 Konkluzion**

Mbeshtetur ne detyren e projektimit dhe duke mare ne konsiderate sygjerimet te bera nga drejtoria e planifikimit u studiuua dhe u paraqiten ne kete projekt zbatim, , seksione terthore tip, projekti i pilotave,projekti i mureve mbajtes.

- Planimetria e projekt-zbatimit gjurma
- Prerje terthore
- Detaje te projektit
- Relacion teknik
- Specifikime teknike
- Preventiv
- Grafik punimesh

Ing. Brunilda Bekaj

**DREJTORIA PLANIFIKIMIT**

**MIMOZA HAXHIU**